



Organizata Jo-qeveritare EC MA NDRYSHE

EC Ma Ndryshe
STRATEGJIA 2020 – 2024
Shkurt 2020, Prizren/Prishtinë

Rr. Fehmi Lladrovci Nr. 94, 20000-Prizren & Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000-Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771

Hyrje

Sapo përfunduar një cikël strategjik pesë vjeçar. Dokumenti strategjik 2015-2019 ishte i pari i këtij lloji në historinë e organizatës, i strukturuar, profesional, me vizion të qartë. Ndonëse ka qenë e pamundur që të zbatohet në tërësi, vlera e shtuar e atij dokumenti (dhe procesi) ka qenë se na ka mësuar të mendojmë, planifikojmë dhe veprojmë në mënyrë strategjike. Pra, duke e sistemuar informacionin dhe planifikuar ndikimin, ne kemi rritur vëllimin dhe besojmë shumë, cilësinë e aktivitetit tonë në pesë vitet e fundit. Në përfundim të ciklit strategjik pesë vjeçar nuk kishte asnjë dilemë që do të vazhdonim me të njëjtën qasje të planifikimit. Pas diskutimeve të brendshme dhe ndihmës së ekspertëve të jashtëm, realizuam një numër diskutimesh me njerëzit tanë, grupet e komunitetit, organizatat partnere, zyrtarë të institucioneve, donatorë dhe të tjerë. Përfundimisht, ky është dokumenti ynë strategjik që do të udhëzojë punën tonë në periudhën e ardhshme pesë vjeçare (2020-2024).

EC edhe më tej do të mbetet çfarë ka qenë nga fillimi, organizatë me bazë në komunitet. Temat dhe çështjet mund të ndryshojnë, por çfarë mbetet konstante është metodologjia. EC beson në nevojën dhe domosdoshmërinë e organizimit komunitar si garancën më të madhe të demokratizimit dhe zhvillimit. Risi në qasjen strategjike të EC (ndonëse e zbatuar në mënyrë sporadike viteve të fundit) është kompotenta e zhvillimit. Demokracia dhe zhvillimi qëndrojnë në marrëdhënie varësie, ndërsa kjo e fundit domosdoshmërisht duhet të zbatohet në korniza qëndrueshmërie. Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson në bashkëpunim të njëmendtë me të gjithë, nga individët e vullnetit të mirë të institucionet publike, gazetarët, banoët e lagjes, donatorët, dhe shumë grupe të tjera të shoqërisë. Vetëm të koordinuar në veprime mund të ofrojmë më të mirën tonë brenda përprjekjeve të përbashkëta për një Kosovë të përparuar në kuptimin demokratik dhe zhvillimor.

Vizioni, Misioni, Vlerat

Vizion

Komuna të qëndrueshme që qeverisen nga të gjithë. (Vendbanime dhe komunitete të qëndrueshme)

Mision

EC angazhohet për qeverisje demokratike dhe ekonomi të qëndrueshme në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqëyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Vlerat

1. *Paanshmëri* – EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion.
2. *Aktivizmi* – Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës.
3. *Orientimi drejt rezultateve* – Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura.
4. *Komuniteti bazë e veprimit* – EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.

Kontekst

Qytetarët e Kosovës vazhdojnë të kenë qasje të limituar në vendimet dhe politikat publike nga të cilat varet cilësia e tyre jetësore. Komunitatet e Kosovës tregojnë prirje të ultë ndaj përfshirjes së qytetarëve, ndërsa përjashtim më i madh u bëhet grupe të nënpërfaqësuar të komunitetit. Pjesa më e madhe e vendimeve varen nga vullneti i një numri të koncentruar grupesh dhe individësh me ndikim. Komunitatet rëndom janë nën ndikimin e bizneseve të mëdha dhe kjo i thëllon problemet e komunitetit duke e vënë buxhetin në shërbim të interesave të grupeve të fuqishme. Kjo si rrjedhojë ka ndikuar në cilësinë e ultë të shërbimeve publike. Konsultimet e kufizuara në hartimin dhe zbatimin e buxheteve veçanërisht kanë ndikuar në vendime komunale që shpesh dështojnë t'i adresojnë nevojat reale të qytetarëve. Me kryetarë që gëzojnë kompetenca të mëdha politike dhe ekzekutive dhe në mungesë të mbikëqyrjes efektive, komunitatet rëndom kanë devijuar në njësi buxhetore me menaxhim të dobët të financave publike. Në zonat urbane të Kosovës problematike mbeten sidomos sfidat e ndërtimeve pa leje, menaxhimit të hapësirave publike, përmirësimit infrastrukturor dhe mobilitetit të përgjithshëm. Përderisa shoqëria civile vazhdon të veprojë nën kapacitetin e dëshiruar, organizimi komunitar vazhdon të mbetet i dobët dhe i fragmentuar.

Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes për t'u përballur me sfidat mjedisore që kanë ndikim të vazhdueshëm në jetesën, shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve. Të sfiduar nga varfëria dhe papunësia e theksuar, shteti dhe shoqëria shtyten ta projektojnë perspektivën zhvillimore larg konsideratave të qëndrueshmërisë, sidomos asaj mjedisore. Ajri, uji dhe toka e Kosovës vazhdimisht sulmohen nga energjetika, metalugjia, deponitë, ndërtimtaria, transporti dhe

projektet e mëdha infrastrukturore. Zonat urbane janë nën mëshirën e veturave të vjetra dhe karburantit jociësor, ngrohjes me thëngjill e dru, menaxhimit të degraduar të mbetjeve dhe zvogëlimit të hapësirave të gjelbra si rezultat i betonizimit. Në anën tjetër, fshati dhe zona malore përballen me sfidat e eksploatimit të lumenjve, prerjes së pyjeve, kontaminimit të tokës bujqësore dhe dëmtimit të biodiversitetit dhe ekosistemeve. Mbi gjithë këto probleme qëndron transparenca dhe llogaridhënia e kufizuar institucionale në proceset e vendimmarrjes mjedisore. Për shkatërrimin e mjedisit mjaftojnë pak njerëz me veprime të mëdha degraduese, ndërsa për mbrojtjen e tij kërkohet angazhimi i të gjithëve.

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta. Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Objektivat strategjike

Në periudhën që mbulon ky dokument strategjik, aktiviteti i organizatës do të synojnë përmbushjen e tri objektivave strategjike:

1. Komunitete lokale të mirorganizuara dhe presioni i rritur publik nxisin praktika të përparuara të qeverisjes demokratike dhe gjithëpërfshirëse në komunat e Kosovës. Konkretisht synojmë:

- a. Praktika të mira të konsultimit dhe përfshirjes publike në vendimmarrjen komunale
 - b. Grupe të komunitetit, organizata dhe media lokale të fuqizuara që sigurojnë mbikëqyrje efektive të vendimmarrjes
 - c. Angazhim direkt të qytetarëve në mbrojtjen dhe përcaktimin e hapësirave publike
 - d. Mbrojtje efektive të strukturës urbane dhe zonave historike të qyteteve të Kosovës
2. Dimensionet mjedisore dhe sociale të integruara në programe dhe politika që synojnë zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm lokal dhe rajonal. Konkretisht synojmë:
 - a. Vendimmarrja komunale që ndjek parimet e QZHQ (SDG) sa herë që planifikon dhe zbaton politika dhe programe zhvillimore
 - b. Mbrojtje efektive të mjedisit, rritje të efijencës energjetike, shtim të zonave të gjelbra dhe konsum të reduktuar në zonat urbane
 - c. Edukimin mjedisor të gjeneratave të reja duke e përfshirë aktivizmin mjedisor në programin e shkollave fillore dhe të mesme
 - d. Projekte dhe programe të përbashkëta zhvillimore me institucionet publike dhe organizatat donatore
 3. Vëllim i rritur i dijes sektoriale për të ushqyer debatin shoqëror dhe politikëbërjen, si dhe një organizatë me shtathtësi të konsoliduara programore dhe qëndrueshmëri institucionale. Konkretisht synojmë:
 - a. Vëllim të rritur të dijes profesionale në shërbim të aktivizmit, avokimit dhe nxitjes së debatit publik
 - b. Ofrim të shërbimeve profesionale për palët e treta si mundësi për të konsoliduar qëndrueshmërinë financiare
 - c. Zhvillim të kapaciteteve të brendshme organizative, profesionale dhe vepruese.

Programet

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. Të njëjtat përbëjnë edhe strukturën programore të organizatës në periudhën e ardhshme pesë vjeçare (2020 – 2024):

1. GJITHËPËRFSHIRJE (Qytete / Komuna Gjithëpërfshirëse)

Programi i Gjithëpërfshirjes është vazhdimësi e veprimeve tashmë të njohura të organizatës, por me në thellësi më të madhe profesionale dhe konceptuale. EC tani trajton angazhimin qytetar dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje përtej nivelit utilitar politik. Qyteti, fshati apo çfarëdo hapësire tjetër (lokalitet banimi dhe jetese) është mbi të gjitha një e drejtë themelore dhe e

pamohueshmë e banorëve. Programi do të fokusohet në zhvillimin e grupeve ekzistuese si dhe në formimin e grupeve të reja të komunitetit në nivele të ndryshme të komunave. Paralelisht me angazhimin për më tepër organizim komunitar, programi synon zhvillimin e mëtejshëm të shkathtësive të grupeve për aktivizim dhe avokim efektiv në raport me institucionet publike. Përfundimisht, programi do të vazhdojë të nxisë ndjenjës e përkatësisë së banorëve në raport me hapësirën publike, duke inicuar platforma të rezitencës qytetare kundër forcave të egra të tregut që rrezikojnë strukturën urbane, trashëgiminë kulturore, peisazhin natyror dhe vlerat e tjera të qyteteve dhe fshatrave të Kosovës.

2. QËNDRUESHMËRI (Zhvillim i Qëndrueshëm)

Programi i Qëndrueshmërisë është përgjigje në pyetjen ‘pse gjithëpërfshirje’. Zhvillimi i përgjithshëm kombëtar, rritja e mirëqenies sociale dhe cilësisë së jetës, të gjitha këto brenda parametrave të qëndrueshmërisë (pra demokraci për zhvillim). Fokusi i programit parasegjithash do të jetë në sfidat mjedisore. Zonat urbane dhe zonat e mbrojtura të natyrës janë më të rrezikuara dhe veprimet e EC do të shtrihen me prioritet në këto hapësira. Për të siguruar vendimmarrje të përgjegjshme komunale, organizata do të avokojë për përkthimin e QZHQ (SDG) në mendësinë dhe praktikën e zhvillimit dhe zbatimit të politikave publike. Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme do të trajtohen si grup me rëndësi të veçantë për të krijuar gjeneratën e së ardhmes që aktivizimin mjedisor e kupton si përgjegjësi sociale. Në mënyrë të veçantë, EC do të krijojë partneritete vepruese me institucionet publike në zbatimin e programeve zhvillimore përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve kulturore dhe natyrore të Kosovës.

3. DIJE (Prodhim i dijes)

EC ka publikuar dhjetëra raporte dhe analiza, rezultat i punës hulumtuese. Dija e prodhuar do të vazhdojë të përdoret për të fuqizuar argumentin avokues. Produktet e hulumtimit do të synojnë temat që mbulohen nga dy programet e para të organizatës. Pjesë e programit të dijes janë edhe shërbimet profesionale, të cilat synojnë të konsolidojnë bazën e qëndrueshmërisë financiare të organizatës. Në të njëjtën kohë, vëmendje e veçantë do t’i kushtohet zhvillimit të mëtejshëm dhe të përhershëm të kapaciteteve të brendshme organizative, profesionale dhe vepruese.

Metodat e punës

EC përdor metodologji të kombinuar të punës. Ndonëse organizatë me bazë në komunitet, EC në vazhdimësi ka konsoliduar kapacitetet hulumtuese dhe analitike. Ndër komponentët më të fuqishëm të organizatës mbeten fokusi ndaj rrjetëzimit të brendshëm (brenda shoqërisë civile) dhe dialogut të politikave me komunat për reformat e domosdoshme. Në vijim, metodat e punës së EC:

- Mobilizimi i komunitetit – EC është në komunikim të përhershëm me grupet e komunitetit dhe përmes nismave synon t'i mobilizojë këto grupe rreth çështjeve të rëndësishme të qeverisjes dhe zhvillimit lokal,
- Monitorimi i komunave – një përpjekje e vazhdueshme që nuk kufizohet vetëm në organet komunale, por prek edhe gjyqësinë, policinë, qeverinë qendrore, etj. Monitorimi gjeneron informacion të bazuar dhe forcon aktivitetin avokuese të organizatës,
- Avokimi për ndryshim – një numër mjetesh përdoren për të ushtruar presion të drejtpërdrejtë ndaj komunave dhe dhe institucioneve tjera shtetërore. Veprimet avokuese të EC synojnë ndryshimin në sferat e transparencës dhe llogaridhënies dhe politikave të zhvillimit të qëndrueshëm,
- Dialogu i politikave – organizata është pjesë e një numri procesesh të dialogut të strukturuar me institucione publike. Dialogu për politika publike ka forma të ndryshme dhe synon rritjen e komunikimit mes qytetarëve dhe institucioneve të shtetit për zbatim efektiv të politikave,
- Rrjetëzimi – Përmes Rrjetit të Organizatave të Kulturës, Forumit Transparenca, Iniciativës për Mbrojtjen e Kino Lumbardhit dhe veprimeve të ngjashme, EC ka dëshmuar se rrjetëzimi është mjef efektiv i avokimit dhe ndryshimit, dhe për këtë arsye vazhdon të jetë një nga metodat më të rëndësishme të punës së organizatës,
- Hulimtimit – EC ka prodhuar një numër të konsiderueshëm dokumentesh të hulumtimit. Gjatë viteve të fundit, organizata ka investuar rregullisht në ngritjen e cilësisë së hulumtimit, ndërsa prej vitit 2015 ka hulumtimin (prodhimin e dijes) si njërin nga tre programet e organizatës. Për të konsoliduar këtë kapacitet, EC ka përgatitur një plan të veçantë që do të udhëzojë zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese të organizatës.

Teoria e ndryshimit

Ndikim	Nivel i përparuar i mirëqenies sociale dhe ekonomike të komuniteteve	
Qëllime	Gjithëpërfshirje në qeverisje dhe jetë publike	Zhvillim i qëndrueshëm i vendbanimeve dhe komuniteteve
	Komunitete të fuqizuara	Burime natyrore dhe kulturore të shfrytëzuara në mënyrë të qëndrueshme
Objektiva	Qytetarë (komunitete) të pajisur me dije, informacion, hapësira, burime financiare dhe kapital social	Qeverisje që prodhon politika dhe programe të bazuara në evidencë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse

Rezultate	Qeverisje transparente dhe llogaridhënese	Zhvillim ekonomik nëpërmjet burimeve kulturore natyrore dhe	Qytete dhe komuna gjithëpërfshirëse	Mobilizim dhe aktivizëm të komuniteteve
Aktivitete	Mbikëqyrje e urbanizmit Përkthim i QZHQ-ve Monitori mjedisor Hulumtime	Programi i mjedisit Turizmi rural Hulumtime Shkolla	Qytete/Komuna gjithëpërfshirëse Hulumtime Shkolla	E drejta mbi qytetin Rikrijimi i hapësirave publike Eko shkolla

Në nivel të ndikimit të synuar, EC synon mirëqenien sociale dhe ekonomike të komuniteteve. Ky realitet i dëshiruar nënkupton përfshirje të të gjithëve në qeverisje dhe jetë publike, zhvillim të qëndrueshëm të vendbanimeve dhe komuniteteve, komunitete të fuqizuara dhe burime natyrore dhe kulturore që shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme. Ky koncept strategjik i të menduarit dhe vepruarit ka shoqëruar punën e organizatës për vite të tëra, ndërsa ka ardhur duke u saktësuar kryesisht si rezultat i monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve dhe rezultateve. Zbërthyer në objektiva, EC angazhohet për komunitete që janë të pajisura me dije, informacion, hapësira, burime financiare e kapital social, si dhe për qeverisje që prodhon politika dhe programe të bazuara në evidencë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Katër janë shtyllat kryesore të rezultateve të dëshiruara, të projektuara për vitet e ardhshme të aktivitetit të organizatës: 1. Qeverisje transparente dhe llogaridhënese, 2. Zhvillim ekonomik nëpërmjet burimeve kulturore dhe natyrore, 3. Qytete dhe komuna gjithëpërfshirëse dhe 4. Mobilizim dhe aktivizëm të komuniteteve. Veprimet e planifikuara të organizatës për arritjen e këtyre rezultateve përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në to: mbikëqyrjen e urbanizmit, monitorimin mjedisor, promovimin e turizmit rural, hulumtimin dhe prodhimin e dijes, organizimin e platformave edukuese (shkollat), mobilizimin dhe fuqizimin e komunitetit, fuqizimin e së drejtës mbi qytetin dhe rikrijimin e hapësirave publike.

Projektet dhe Nismat

Një numër programesh projektesh dhe nismash do të zbatohen në periudhën strategjike 2020-2024. Lista e mëposhtme është tentative dhe ajo mund të ndryshojë muajve dhe viteve në vijim

në varësi të një numri faktorësh dhe dinamikash. Sidoqoftë, EC synon zbatimin e të paktën këtyre projekteve dhe nismave në kuadër të tri programeve:

1. GJITHËPËRFSHIRJE (Qytete / Komuna Gjithëpërfshirëse)

- *Qytete/Komuna gjithëpërfshirëse*

Organizimi i grupeve të komunitetit kryesisht në nivel të lagjes dhe fshatit për t'i avokuar kërkesat dhe interesat e tyre në raport me institucionet publike. Rritje e pjesëmarrjes publike në zhvillimin dhe zbatimin e politikave komunale që lidhen me planifikimin hapësinor.

- *E drejta mbi qytetin*

Avancimi i Kartës së Qytetit në nivel praktik, pas hartimit të tij në një proces gjithëpërfshirës dhe miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit. Promovimi i modelit edhe në komunat e tjera të Kosovës dhe bashkëpunimi mes komunave për të zhvilluar konceptin e të drejtës mbi qytetin.

- *Mbikëqyrje e urbanizmit*

Mbikëqyrje e aktivitetit ndërtues në qytetet e Kosovës, me fokus në zonat historike dhe zonat rrethuese të monumenteve të trashëgimisë kulturore. Monitorim i aktivitetit institucional dhe biznesor në raport me dëmtimin e hapësirës publike dhe ngritja e alarmeve parandaluese ndaj degradimit urban.

- *Rikrijimi i hapësirave publike*

Vazhdimësi e punës së dizajnit komunitar dhe ndërhyrjes faktike për rregullimin e pesë hapësirave publike në qytetin e Prizrenit. Zgjerim i metodologjisë në zonat e tjera të Prizrenit, si dhe bartje në qytetet e tjera të Kosovës.

2. QËNDRUESHMËRI (Zhvillim i Qëndrueshëm)

- *Programi i mjedisit*

Partneritet me komunat e Kosovës për përfshirjen e konsideratës mjedisore në zhvillimin e politikave publike. Edukimi mjedisor i grupeve të komunitetit, me fokus të rinjtë dhe aktivizimi i tyre mjedisor. Veprime për t'u përshtatur dhe penguar ndryshimet klimatike.

- *Turizmi rural*

Promovimi i potencialit dhe rritja e vlerës turistike të fshatrave dhe zonave të caktuara malore në Kosovë. Një qasje e qëndrueshme ndaj zhvillimit dhe krijimit të vendeve të punës në zonat rurale, duke siguruar shfrytëzim të pakomprometuar të burimeve natyrore dhe kulturore.

- *Eko shkolla*

Projekt i cili bazohet në konceptin “eko shkollë”, një model dhe metodologji që inkurajon të rinjtë të përfshihen në mjedisin e tyre duke u lejuar atyre mundësinë që ta mbrojnë atë në mënyrë aktive.

- *Përkthim i QZHQ-ve*

Përkthimi i Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG, Agenda 2030) në kornizë të qeverisjes komunale që siguron një udhërrëfyes efektiv për zhvillim të qëndrueshëm dhe matje të progresit në nivel lokal dhe komunitar.

- *Monitori mjedisor*

Përmirësimi i paramentrave mjedisorë përmes një sistemi të strukturuar monitotorimi dhe publikimi të informacionit mjedisor. Përpjekje për të fuqizuar argumentin avokues të shoqërisë civile dhe medias si mënyrë e nxitjes së vëmendjes institucionale në përmbushjen e detyrimeve mjedisore që dalin nga MSA.

3. DIJE (Prodhim i dijes)

- *Hulumtime*

Publikimet e organizatës do të jenë forma përfundimtare e hulumtimeve me metoda të ndryshme, në tema që janë me interes për dy programet kryesore. EC do të vazhdojë të përdorë kapacitetet e brendshme si dhe të angazhojë ekspertizë të jashtme nga databaza e profesionistëve.

- *Shërbime*

Ofrimi i shërbimeve profesionale është aktivitet i ndieshëm dhe serioz, që kërkon analizë dhe përgatitje të duhur. Shërbimet në të cilat EC mund të kenë përkarësi krahasuese dhe mund të konkurrojnë në treg janë: organizimi i ngjarjeve, hulumtime dhe analiza, trajnime në metoda të mobilizimit komunitar, menaxhim financiar dhe qëndrueshmëri financiare.

- *Shkolla*

Një numër programesh të EC (shkolla) kanë aftësuar gjenerata të ndryshme në tema që lidhen me planifikimin hapësinor, aktivizmin, trashëgiminë kulturore, mjedisin, integrimin europian dhe të ngjashme. Shkollat do të jenë pjesë e rëndësishme e programit të dijes edhe gjatë periudhës së re strategjike.

- *Zhvillim i kapaciteteve*

Aktivitet i përhershëm i organizatës, që do të vazhdojë edhe në periudhën e re strategjike.

Burimet e financimit

EC ka një histori pozitive dhe mjaft të balancuar të financimit. Performansa financiare e organizatës ka qenë e kënaqshme, ndërsa viti 2019 ka shënuar nivelin më të lartë ndonjëherë të buxhetit vjetor. Organizata nuk ka varshmëri të madhe nga ndonjë donator specifik dhe ka

siguruar shpërndarje të balancuar të donatorëve në raport me kontributin e tyre. Deri tani, EC ka siguruar financim kryesisht nga donatorë të huaj që veprojnë në Kosovë (fondacione, filantropi, agjenci zhvillimore, ambasada). Në periudhën e ardhshme pesë vjeçare, EC synon diversifikimin e burimeve të financimit, duke synuar këto burime:

- Grante të projekteve
- Grante institucionale
- Ofrimi i shërbimeve
- Pagesa e anëtarësisë
- Financimi korporativ
- Fonde publike
- Crowdfunding